

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektsh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Pjese e rëndësishme e portofolit të investimeve të Gener 2 janë dhe Njesite tregtare si: Qendra Tregtare Toptani, ABA Business Center dhe COIN, Restaurant, Fusion Dining & Cocktails.

❖ TITULLI I POZICIONIT TË PUNES

Punonjes Magazine COIN

❖ DETYRAT KRYESORE

- Transporti në kohë dhe saktë të produkteve nga magazina në dyqan dhe anasjelltas. Siguria e mjeteve të transportit dhe produkteve. Finalizimi i transportit me shkarkimin e tyre dhe dorezimin tek personat përgjegjës.
- Procesi i perpunimit të produkteve duke filluar me numerimin me palmar, vendosjen e cmimeve dhe sensoreve. Ky proces duhet kryer në kohë dhe saktë.
- Mirembajtja e magazines përfshin procesin e pastrimit, sistemit të produkteve dhe ambalazhimit të tyre, inventarizimit të aseteve dhe produkteve me gjendje reale në çdo kohë, mirembajtje të sistemit të sigurisë dhe elementeve të magazinimit.

❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Arsim i Mesëm;

Njohuri kompjuterike: MSC Office dhe sistemi stokut;

Të disponojë patente të Kategorisë B

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur që të dergojnë CV nepermjet adresës së e-mailit careers@gener2.al ose të plotësojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare www.gener2.al në seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit është **data 15 Prill 2022, ora 17:00**.

* Vetëm kandidatet e perzgjedhur do të kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrotjtjen e të dhënave personale”.